REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

Nr. 2709 **prot.**

Lushnje, më 17/03/**2026**

PROJEKT - VENDIM

Nr. 35 **Datë** 17/03/**2026**

"PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI TË TRANSPARENCËS SË BASHKISË LUSHNJE"

Këshilli Bashkiak Lushnje në mbledhjen e tij të dates ___/___/2026 pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Koordinatori i të Drejtës së Informimit mbi Programin e Ri Institucional të Transparencës (PT) sipas formës dhe përmbajtjes në përputhje me Lidhjen nr. 1 *(bashkëlidhur Urdhërit nr. 281 datë 30.12.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale)*, në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", i ndryshuar, neni 5 dhe neni 6, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 15 pika 3 , si dhe të Urdhërit nr 281 datë 30.12.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore", Këshilli Bashkiak Lushnje,

PROPOZON:

1. Miratimin e Programin të Ri Institucional të Transparencës (PT) të Bashkisë Lushnje *(sipas formës dhe përmbajtjes në përputhje me Lidhjen nr. 1 bashkëlidhur ketij Projekt – Vendimi).*

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Koordinatori i të Drejtës së Informimit, Sektori i IT dhe Inovacionit si dhe të gjitha Drejtoritë e Bashkisë Lushnje.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kordinatori i të Drejtës së Informimit
Blerina Mebelli

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

R + P.

Transferuar
Eusebio Sefo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIALUSHNJE
KOORDINATORI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT

Nr.2708 Prot.

Lushnje, më 17 / 03 /2026

RELACION
PËR NË KËSHILLIN BASHKIAK

"PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI TË TRANSPARENCËS SË BASHKISË LUSHNJE"

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Këshilltarë,

Programi i ri Institucional i Transparencës (PT), synon të rrisë shkallën e llogaridhënies dhe aksesin e qytetarëve në informacionin publik të Bashkisë Lushnje.
Ky dokument vjen si nevojë e përshtatjes me standardet më të fundit të miratuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, duke zëvendësuar kështu formatin e vjetër të vitit 2018.
Në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, neni 6, **Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"**, si dhe të Urdhërit nr. 281 datë 30.12.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Për miratimin e Programit Model të Transparences për Njesitë e Vetëqeverisjes Vendore", Bashkia Lushnje do të miratojë Programin e Ri Institucional të Transparencës (PT) sipas formës dhe përmbajtjes në përputhje me Lidhjen nr. 1 *(bashkëlidhur Urdhërit nr. 281 datë 30.12.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale)*, sipas Lidhjes nr. 1 bashkëlidhur ketij Relacioni.
Programi i ri i Transparencës (PT), është i strukturuar në 8 fusha kryesore, duke mbuluar çdo aspekt të veprimtarisë së Bashkisë Lushnje:

- **Fusha 1 & 2 (Organizimi administrativ - territorial, misioni dhe funksionet e Bashkise Lushnje dhe Transparenca dhe llogaridhënia ekonomike - financiare):** Kërkon publikimin e strukturës, pagave, buxhetit vjetor dhe raporteve të auditimit.
- **Fusha 3 (Kërkesat për informim):** Të dhënat personale të Koordinatorit të së Drejtës së Informimit duhet të jenë publike, si dhe regjistri i kërkesave dhe i kthimit të përgjigjeve qytetarëve të interesuar, të publikohen në faqen zyrtare të webit të Bashkisë Lushnje www.bashkialushnje.gov.al .
- **Fusha 4 (Shërbimet):** Bashkia duhet të bëjë publike listën e shërbimeve administrative, tarifat përkatëse dhe procedurat për përfitimin e tyre.

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 e-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

- **Fusha 5 (Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore):** Bashkia Lushnje duhet të publikojë të gjithë legjislacionin si dhe aktet e brendshme rregullatore që zbaton në përditshmëri.
- **Fusha 6 (Pjesëmarrja qytetare ne vendimmarrje):** Përcakton detyrimin për njoftimin e konsultimeve publike dhe publikimin e raporteve vjetore mbi komentet e pranuara nga qytetarët.
- **Fusha 7 (Informacion tjeter):** Këtu përfshihet bërja publike e informacionit mbi të dhënat e projekteve në kuadrin e integrimit në Bashkimin Europian, të dhëna për OJF- të si dhe nisma advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqeria civile, bërjen publike të raporteve, studimeve dhe vlerësimeve mbi zbatimin e Programit te Transparencës.
- **Fusha 8 (Këshilli Bashkiak):** Kjo është risia kryesore e (PT), ku kërkohet publikimi i listës së këshilltarëve,biografia e tyre si dhe nr e tyre te kontaktit .

Informacion rreth komisioneve ku përfshihet bërja publike e përbërjes së komisioneve, njoftimi për takimet e komisioneve, axhenda dhe dokumentat për diskutim si dhe raportet e mbledhjeve të komisioneve për projekt-vendimet e diskutuara, si dhe kuadri ligjor rregullator i Këshillit Bashkiak Lushnje.

Në përputhje me pikën 3 të Urdhrit nr. 281, Bashkia Lushnje duhet ta zbatojë këtë program jo më vonë se data **31 mars 2026**.

Programi do të jetë i aksesueshëm në faqen zyrtare të internetit www.bashkialushnje.gov.al dhe në Këndin e Njoftimeve publike të institucionit.

Miratimi i këtij programi nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një dritare e vogel për të siguruar që çdo qytetar i Lushnjes të ketë akses të shpejtë, pa kërkesë dhe pa pagesë në dokumentet zyrtare, duke rritur besimin te qeverisja lokale.

KOORDINATORI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT
Blerina Mebelli

2026

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 e-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com